



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 22 prill 2014  
Nr. ref.:AGJ602/14

## **AKTGJYKIM**

në

**Rastin Nr. KI89/13**

Parashtrues

**Arbresha Januzi**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,  
Rev. Nr. 74/2011, të 12 marsit 2013**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtrues i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Arbresha Januzi, me banim në Prishtinë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 74/2011 i 12 marsit 2013, të cilin parashtruesja e ka pranuar më 29 maj 2013.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekti i çështjes se kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 74/2011 të 12 marsit 2013, përkitazi me shkeljet e pretenduara kushtetuese të garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]; nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]; nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], posaçërisht shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNj-së.

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 20 dhe 47 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 19 qershor 2013, parashtruesja e kërkesës parashtrroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 24 qershor 2013, Kryetari i Gjykatës me vendim nr. GJR. KI89/13 caktoi zëvendëskryetarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë Kryetari i Gjykatës me vendim nr. KSH. KI89/13 emëroi anëtarët e Kolegjit shqyrtues në këtë përbërje: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 2 korrik 2013, Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën Supreme dhe parashtruesen e kërkesës, për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 26 gusht 2013, parashtruesja dorëzoi Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 32/2013 në Gjykatë.
9. Më 30 gusht 2013, Gjykata kërkoi nga Gjykata Supreme dorëzimin e kopjes së vërtetuar të Aktgjykimit Rev. nr. 32/2013.
10. Më 4 shtator 2013, parashtruesja dorëzoi serish dokumentacionin shtesë.

11. Më 5 shtator 2013, Gjykata Supreme dorëzoi kopjen e Aktgjykimit Rev. nr. 32/2013, të 30 korrikut 2013, të kërkuar nga Gjykata, më 30 gusht 2013.
12. Më 23 shtator 2013, parashtruesja serish dorëzoi dokumentacion shtesë për rastin e saj. Në këtë parashtrësë parashtruesja përmend disa Aktgjykime të Gjykatës Supreme, që e njëjta kishte vendosur para rasti të saj, që ajo i konsideron të ngjashme me rastin e saj. Mes tjerash ajo mëton se, *“me dispozitat ligjore të Rregullores 2001/27, për LTHPK dhe me aktin normativ të punëdhënësit ishte paraparë që të zhvillohej procedura disiplinore, e që fare nuk është zhvilluar asnjë procedure disiplinore në rastin tim”*
13. Më 12 mars 2013, Gjykata, shqyrtoi kërkesën dhe votoi për pranueshmërinë dhe meritat e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

14. Më 17 mars 2004, parashtruesja, lidhi kontratë pune (kontrata: nr. 446/04) me Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi) për periudhë të pacaktuar kohore, me pozitë: stjuardesë tokësore.
15. Më 18 maj 2005, parashtruesja nga punëdhënësi i saj ishte njoftuar për ndërprerjen e menjëhershme të kontratës së punës. Ndërprerjen e marrëdhënies së punës, punëdhënësi e kishte bazuar në inicimin e procedurës penale nga policia kufitare e Kosovës, në nenin 13 të kontratës së punës dhe nenin 11.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/27 mbi Ligjin themelor të punës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja. 2001/27, për LTHPK).
16. Më 18 maj 2005, parashtruesja kundër njoftimit p.n. të 17 majit 2005, paraqiti ankesë tek drejtori i menaxhmentit të Aeroportit.
17. Përgjigja në ankesën e parashtrueses, sipas shkresave të lëndës mban datën 26 qershor 2005, mirëpo shkresa në fjalë i është dorëzuar asaj nga punëdhënësi i saj më 15 shkurt 2006, në seancë shqyrtuese.
18. Më 25 gusht 2005, parashtruesja, kundër njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ushtroi padi në Gjykatën Komunale të Prishtinës. Më këtë padi parashtruesja kërkoi anulimin e njoftimit p.n. të 17 majit 2005, si të kundërligjshëm, nga shkak se, sipas të autorizuarit të parashtrueses, “në bazë të dispozitave ligjore në aplikim parashtruesja ka mundur të suspendohet gjer në përfundimin e procedurave, dhe assesi t’i ndërpritej marrëdhënia e punës. I autorizuari i parashtrueses gjithashtu ka pohuar se, “nuk qëndrojnë thëniet e punëdhënësit se gjoja parashtruesja ka zbuluar fshehtësitë afariste. Për këto shkaqe, sipas parashtrueses, ndërprerja e

kontratës së punës, nga ana e punëdhënësit të saj është bërë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores. 2001/27, për LTHPK

19. Më 19 dhjetor 2007, Gjykata Komunale e Prishtinës (Aktgjykimi: Cl. Nr. 208/06) aprovoi kërkesëpadinë e parashtrueses dhe anuloi si të kundërligjshëm vendimin e punëdhënësit për shkëputjen e marrëdhënies së punës. Gjykata në fjalë urdhëroi punëdhënësin që parashtruesen ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes së saj profesionale, me të gjitha të drejtat që burojnë nga marrëdhënia e punës, duke filluar nga 14 maji 2005, si dhe detyroi punëdhënësin që parashtrueses së kërkesës t'ia kompensojë pagën duke zbatuar dhe kamatën ligjore për pagat e humbura. Në vijim pjesë të cituara nga Aktgjykimi:

*“Gjykata për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike e zhvilloj procedurën e provave me leximin e kontratës së punës nr. 446/04 të dt. 17.03.2004, njoftimit mbi ndërprerjen e kontratës së punës, pa numër dt. 17.05.2005, ankesën e paditëses të datës 17.05.2005, përgjigjen në ankesë të paditurës të dt. 26.05.2005 e dorëzuar në gjykatë me dt. 15.02.2006, si dhe aktgjykimin e kësaj gjykatë P. nr. 1338/05, të dt.10.10.2005.*

*[...]*

*Sipas vlerësimit të kësaj gjykatë, shkëputja e kontratës së punës të paditëses, nga ana e të paditurit duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore është në kundërshtim me dispozitat e nenit 11, 11.1, 11.2 dhe 11.3 të Ligjit themelor të punës në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27. Sepse, dispozitat e mësipërme ligjore janë përfshirë në pikën 11.3 me ç'rast rastet e rënda të sjelljes së keqe paraqesin: kundërshtimin e paarsyetuar në kryerjen e detyrave të përcaktuara në kontratën e punës; vjedhjen, shkatërrimin, dëmtimin ose shfrytëzimin e paautorizuar të pasurisë së punëdhënësit; zbulimin e fshehtësisë afariste, përdorimin e drogave dhe të alkoolit në punë; dhe sjelljet e natyrës aq të rëndë, pas së cilës do të ishte e paarsyeshme që të pritët që të vazhdohet marrëdhënia e punës edhe më tej. E që kjo rezulton se asnjëra nga këto raste të rënda të sjelljes së keqe nuk kanë të bëjnë me rastin e paditëse, e cila nuk ka kundërshtuar pa arsye kryerjen e detyrave të punës, nuk ka vjedhur, shkatërruar, dëmtuar dhe shfrytëzuar pa autorizim pasurinë e punëdhënësit, nuk ka zbuluar fshehtësinë afariste, nuk ka përdor drogë dhe alkool në punë [...].*

*Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike, gjykata vlerëson se, punëtori përgjigjet vetëm për shkeljet e obligimeve të punës të cilat në kohën e kryerjes kanë qenë të përcaktuara me dispozitat ligjore dhe me aktin e përgjithshëm juridik të ndërmarrjes, të paraparë me dispozitën e nenit 111 par. 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës (Gaz. Zyrt. E KSAK, nr 12/89) Dhe nga këto Shkaqe gjen se paditëses Arbëresha Januzi, në mënyrë të kundërligjshme i është shkëputur Kontrata e punës nr.*

*446/04 e dt. 17.03.2004, përkatësisht i është ndërprerë marrëdhënia e punës, prandaj kërkesëpadinë e paditëses e aprovon në tërësi si të bazuar.”*

20. Punëdhënësi i parashtrueses, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
21. Më 30 dhjetor 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi: Ac. nr. 421/2008), refuzoi ankesën e punëdhënësit, si të pathemeltë, duke vërtetuar kështu aktgjykimin e gjykatës së instancës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm.
22. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës Ac. nr. 421/2008, punëdhënësi i parashtrueses, ushtroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ankesa e punëdhënësit të parashtrueses bazohej në shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
23. Më 13 mars 2013, Gjykata Supreme (Aktgjykimi: Rev. nr. 74/2011) aprovoi revizionin e ushtuar nga punëdhënësi i parashtrueses dhe ndryshoi vendimet e gjykatave të instancës më të ulët. Gjykata Supreme arsyeton aktgjykimin e saj, në faktin se gjykatat e instancës më të ulët, në mënyrë të drejtë dhe të plotë vërtetuan gjendjen faktike, por gabimisht zbatuan të drejtën materiale (ligjin) kur kanë gjykuar se kërkesëpadia e parashtruese është e bazuar. Në vijim arsyetimi i aktgjykimit në fjalë:

*“Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka përfunduar se gjykata e shkallës së parë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur ka miratuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar. Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka përfunduar se në bazë të nenit 13.3 (a,b,c,ç,d) (vërejtje:duhet të jetë nenin 11.3) të Ligjit themelor të punës në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27, veprimet e paditëses nuk kualifikohen si shkelje e rëndë e detyrave të punës pasi që shkeljet e këqija sipas pikës b), kanë të bëjnë me pasurinë e punëdhënësit, e jo me pasurinë e personit të tretë.*

*Qëndrimi i këtillë juridik i gjykatës së shkallës së parë nuk mund të pranohet si i drejtë pasi që me nenin 11.3 të Ligjit themelor të punës është paraparë që kontrata e punës shkëputet nga punëdhënësi në rastet e rënda të sjelljes së keqe ose të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga punëmarrësja, në nenin 11.3 taksativisht janë numëruar rastet e sjelljes së keqe. [...] Sipas kësaj gjykate, vjedhja në vend të punës cilësohet si sjellje e keqe e natyrës së rëndë pas së cilës do të ishte i paarsyeshëm vazhdimi i marrëdhënies së punës së paditëses, kjo nga fakti se sjellja e keqe e vë në dyshim integritetin e saj moral që të kryejë ato punë, kjo reflekton edhe te punëtorët e tjerë si dhe në*

*imazhin e të paditurës [...] Për arsyet e lartcekura me të drejtë theksohet në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë në bazë të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale për çka u desh që të dy aktgjykimet të ndryshohen dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditëses”.*

### **Pretendimet e parashtrueses së kërkesës**

24. Parashtruesja, pretendon se Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 74/2011 të 12 marsit 2013, ia ka shkelur asaj të drejtat kushtetuese të garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]; nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]; nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, posaçërisht shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.
25. Parashtruesja, më tutje argumenton se Gjykata Supreme, me të njëjtën bazë ligjore, sikurse të rastit e saj, me aktgjykimin Rev. nr. 32/2013, aprovoi kërkesëpadinë e dy të punësuarave tjera, në rrethana tërësisht identike. Ajo mëton se “Gjykata Supreme ka ndërtuar praktikë të ndryshme gjyqësore për rastet tërësisht të njëjta dhe kjo vërteton padyshim, pohon parashtruesja, se mua më është shkelur e drejta për “gjykim të drejtë”.
26. Parashtruesja gjithashtu i referohet Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht Rastit KI120/10 të 29 janarit 2013, ku Gjykata gjeti shkelje të nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ, përkitazi me dështimin e Gjykatës Supreme, për të dhëne arsyetimin e duhur në aktgjykimin e saj.

### **Rasti i dy të punësuarave tjera, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 32/2013, i 30 korrikut 2013, për të cilin parashtruesja pretendon se është plotësisht i njëjtë me rastin e saj**

27. Parashtruesja e kërkesës, për arsye të argumentimit të kërkesës se saj, në mbështetje të pretendimit të saj për shkeljet e supozuara të të drejtave kushtetuese, kërkesës së saj, ndërkohë ia ka bashkëngjitur aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 32/2013 të 30 korrikut 2013, ku sipas parashtrueses rasti i saj dhe i dy kolegeve të saja janë tërësisht të njëjta. Në këtë aktgjykim Gjykata Supreme kishte refuzuar revizionin e punëdhënësit (Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës) dhe aprovoi kërkesëpadinë e paditëseve, duke vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët, me të drejtë vendosën për anulimin e vendimeve të punëdhënësit, përkitazi me ndërprerjen e kontratës së punës së tyre. Gjykatat e instancës me të ulët vlerësuan se ndërprerja e kontratës së punës, ishte në kundërshtim me dispozitat e Rregullores 2001/27, për LTHPK-së dhe me aktin normativ të punëdhënësit, sepse punëdhënësit nuk kishte përfillur procedurat e parapara në nenin 11.5 të Rregullores 2001/27, për LTHPK, respektivisht

nuk zhvilloi procedurat disiplinore të parapara me ligjin e aplikueshëm dhe me aktin normativ të punëdhënësit.

28. Në vijim, arsyetimi i Aktgjykimit: *“Për këtë rast e paditura është njoftuar nga policia kufitare e aeroportit dhe drejtori menaxhues i të paditurës me datën 23.12.2008 ka marrë vendimet për shkëputjen e marrëdhënies së punës për të dy paditëset. Vendimet janë marre në baze të dispozitës së nenin 8 të Rregullores së politikave të stafit të aeroportit dhe nenit 11.3 të Ligjit themelor të punës-Rregullorja 2001/27, me arsyetim se paditëset kanë kryer sjellje të natyrës së rëndë pas së cilës do të ishte e paarsyeshme që të pritët vazhdimi i marrëdhënies së punës.*

[...]

*Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se është e bazuar kërkesëpadia e paditësve në pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë.*

*Është i drejtë konstatimi i gjykatave të instancës më të ulët se dispozita e nenit 11.3 (d) të Ligjit themelor të punës, si rast të rëndë të sjelljes së keqe, e cila është bazë për shkëputjen e kontratës së punës nga punëdhënësi, parasheh sjelljen e natyrës tepër të rëndë pas së cilës do të ishte e paarsyeshme që të pritët vazhdimi i marrëdhënies së punës edhe më tej.*

*Mirëpo, për të shkëputur kontratën e punës për këtë bazë ligjore, i njëjti ligj në nenin 11.5. parasheh se në këtë rast punëdhënësi do të njoftojë punonjësin me shkrim për qëllimin e tij për të ndërprerë kontratën e punës, e ky njoftim përfshin edhe shkaqet për shkëputjen e kontratës së punës dhe se punëdhënësi do të mbajë një takim me punonjësin me ç’rast do t’ia shpjegojë me gojë shkaqet e shkëputjes së kontratës. Në rastin konkret nuk është vepruar kështu, por drejtori menaxhues ka marrë vendimet me shkrim dhe ato u janë dorëzuar paditësve pa i përfillur procedurat e përshkruara më lart.*

*Andaj, Gjykata Supreme e aprovoi si të drejtë konstatimin e gjykatave të instancave më të ulëta në pjesën që ka të bëjë me aprovimin e kërkesëpadsë të paditësve dhe vërtetimit se janë nul vendimet e drejtorit menaxhues të të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësve-dispozitivi I i aktgjykimit të shkallës së parë si dhe me pjesën II të dispozitivit, e cila ka të bëjë me kthimin e paditësve në vendin e mëparshëm të punës. Në këto pjesë, aktgjykimi i atakuar është marrë me aplikimin e drejtë të dispozitave të procedurës kontestimore si dhe të së drejtës materiale”.*

**Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, rasti KI120/10, Zyma Berisha, miratuar më 29 janar 2013, për të cilin parashtruesja pretendon se është i aplikueshëm në rastin e saj.**

29. Në aktgjykimin e saj, rasti KI120/10, Zyma Berisha, të 29 janarit 2013, znj. Berisha pretendonte, si në vijim: “Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev. nr. 308/2007, e 10 qershorit 2010, e kishte vënë atë në pozitë të pabarabartë vis-a-vis ish-kolegëve, të cilët kanë qenë në situatë të njëjtë me të, gjegjësisht që kanë pasur statusin e punësimit të përhershëm në kompaninë e njëjtë dhe kanë fituar rastin në Gjykatën Supreme, më pas janë kthyer në vendet e tyre të mëparshme të punës.

*Parashtruesja e kërkesës kishte argumentuar se vetëm në rastin e saj është vendosur ndryshe në Gjykatën Supreme, dhe kështu ajo ka rënë viktimë e padrejtësisë dhe e diskriminimit. Fillimisht, ajo i ka bashkangjitur kërkesës së saj dy aktgjykimet e Gjykatës Supreme, të dyja janë nxjerrë më 17 janar 2008 (Rev. nr. 126/2007 dhe Rev. nr. 177/2007), të cilat kanë të bëjnë me dy ish-kolegët e saj, me ç’rast, në parashtruesën e saj me shkrim të 26 shtatorit 2011, parashtruesja i kishte përmendur emrat e 6 ish-kolegëve të saj që e kishin fituar rastin në Gjykatën Supreme (duke përfshirë emrat e dy kolegëve, aktgjykimet e të cilëve tashmë i ka dorëzuar)”.*

30. Gjetjet e kësaj gjykate, në këtë rast: “Në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës kërkoi nga gjykatat e rregullta konfirmimin e statusit të saj të përhershëm të punësimit në të njëjtën mënyrë siç kanë vepruar në rastet e ish-kolegëve të saj. Ajo iu referua, në veçanti, dispozitave të Marrëveshjes kolektive në fuqi, përkitazi me statusin e saj të punësimit, si dhe dispozitave përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut për Ligjit Themelor të Punës në Kosovë. Gjithashtu, ajo paraqiti prova se kishte të drejtë të gëzonte të gjitha të drejtat nga statusi i punësimit të përhershëm, siç kishin konfirmuar gjetjet e Inspektoratit të Punës. Sa i përket aktgjykimeve të Gjykatës Supreme në rastet identike të ish-kolegëve të saj, në bazë të fakteve të ngjashme me ato të rastit të parashtrueses, parashtruesja e kërkesës në mënyrë legjitime mund të priste refuzimin e revizionit të iniciuar nga Kosova e re.

*Megjithatë, edhe pse Gjykata Supreme, siç shihet nga teksti i aktgjykimit të kontestuar, gjeti se gjykatat e instancës më të ulët kanë konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike për faktet vendimtare për një gjykim të drejtë të rastit, kjo, me sa duket, nuk ka analizuar pretendimin e parashtrueses së kërkesës në të njëjtën mënyrë siç ka vepruar në rastet e ish-kolegëve të saj dhe siç kishte vepruar gjykata e instancës më të ulët në rastin e parashtrueses. Në vend të kësaj, pikëpamja e Gjykatës Supreme, përkundër parashtrësive të parashtrueses, si objekt të çështjes në rastin e saj ka konsideruar vazhdimin e kontratës me kohë të caktuar dhe aspak nuk ka marrë parasysh argumentet dhe provat e parashtrueses sa i përket pretendimeve të saj se ka të drejtë për status të përhershëm të punësimit dhe për kthim në vendin e saj të punës.*

*Kështu që, edhe pse parashtruesja në mënyrë të qartë kishte ngritur çështjen e statusit të përhershëm të punësimit në po të njëjtën mënyrë si*



*edhe ish-kolegët e saj para Gjykatës Supreme, Gjykata Supreme e konsideroi ankesën e saj vetëm si çështje të vazhdimit të kontratës.*

*Rrjedhimisht, Gjykata Supreme, në aktgjykimin për rastin e parashtrueses së kërkesës, vendosi ndryshe nga rastet e tjera identike të ish-kolegëve të parashtrueses. Në vend të gjetjeve të atyre rasteve se gjykatat e instancave më të ulëta “kanë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar”, në rastin e parashtrueses, Gjykata Supreme gjeti se gjykatat e instancave më të ulëta “gabimisht kishin zbatuar të drejtën materiale kur gjetën se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.*

*Gjykata Supreme, më tej, konstatoi: “Qëndrimi juridik i gjykatave të instancës më të ulët se paditëses është dashur t’i vazhdohet kontrata e punës meqë vendi i punës në të cilin ajo ka punuar ekziston sipas akteve normative të të paditurës, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, ishte në kundërshtim me dispozitat e ligjit të lartpërmendur, duke pasur parasysh që kontrata për vazhdimin e marrëdhënies së punës mund të lidhet me pëlqimin e punëdhënësit dhe të punonjësit, nëse nuk është në kundërshtim me ligjin dhe me aktet normative, prandaj paditëses i është shkëputur kontrata e punës me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit”.*

*Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të vendosë se cila do të ishte mënyra më e përshtatshme për Gjykatën Supreme që të merrej me argumentet e parashtrueses përkitazi me statusin e saj të punësimit të përhershëm në bazë të marrëveshjes së përmendur kolektive dhe ligjit në fuqi.*

*Megjithatë, sipas opinionit të Gjykatës Kushtetuese, aktgjykimi i Gjykatës Supreme, duke neglizhuar vlerësimin e duhur të argumenteve të parashtrueses përkitazi me statusin e përhershëm të punësimit, edhe pse ato ishin specifike, relevante dhe të rëndësishme, nuk i plotësoi detyrimet e Gjykatës Supreme sipas nenit 6.1 të KEDNJ-së për të plotësuar detyrimet e cekjes së arsyeve (Shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Aktgjykimi i 18 korrikut 2006, në rastin Pronina kundër Ukrainës, Kërkesa nr. 63566/00; Shih, gjithashtu, Aktgjykimin e Gjykatës në Rastin Nr. KI40/09, Imer Ibrahimimi dhe 48 punonjës të tjerë të KEK-ut, gjegjësisht “Aktgjykimi i KEK-ut”).*

*Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, në Aktgjykimin Rev. nr. 154/2008, e 7 shkurtit 2011, gjegjësisht 7 muaj pas aktvendimit të saj në rastin e parashtrueses, nuk përsëriti gjetjet e veta në rastin e parashtrueses, por përsëri vendosi në po të njëjtën mënyrë, siç kishte vepruar në katër rastet para rastit të parashtrueses së kërkesës, duke konsideruar konfirmimin e statusit të përhershëm të punësimit si objekt të çështjes së kontesteve dhe duke përdorur arsyetime të ngjashme*

voluminoze dhe të detajuara për të refuzuar revizionin e paraqitur nga “Kosova e re”.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese gjen se Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë të dukshme arbitrare në rastin e parashtrueses së kërkesës, në kundërshtim me parimet e shtjelluara nga GJEDNJ-ja në aktgjykimin e vet, të përmendur më lart, në rastin Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë [GC], nr. 13279/05, 20 tetor 2011.

Prandaj, Gjykata konkludon se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.”

### **Pranueshmëria e kërkesës**

31. Në mënyrë që të jetë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesja i ka plotësuar kërkesat për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, të specifikuara më tutje në Ligj dhe në Rregullore të punës së Gjykatës.
32. Gjykata, së pari vlerëson nëse parashtruesi është pale e autorizuar sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton: *"Individët janë të autorizuar të ngrëne shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë [...]"*. Në këtë drejtim, kërkesa është dorëzuar nga parashtruesja, në bazë të nenin 113.7 të Kushtetutës (Kërkesat Individuale), prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesja, në këtë rast, është palë e autorizuar dhe ka të drejtë ta parashtroi këtë rast në Gjykatë.
33. Gjykata, po ashtu, duhet të përcaktojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kërkesat e shterimit të mjeteve efektive juridike, të përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 47.2 të Ligjit, që përcakton: *"[...] Individit mund ta ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.
34. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet Rastit KI41/09, të vetë kësaj Gjykate, ku thuhet: *"Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi mbi kërkesën e shterimit, siç është interpretuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih nenin 53 të Kushtetutës), është që t'ju ofrojnë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se korniza ligjore e Kosovës do të sigurojë mjete efektive për mbrojtje nga shkelja e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih, mutatis mutandis, ECHR, Selmouni v. France, nr. 25803/94, Vendim i datës 28 korrik 1999). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të cekën në mënyrë eksplicite gjatë procedurës në fjalë. Derisa kjo çështje është cekur në mënyrë absolute ose substanciale, kërkesa mbi shterimin e mjeteve është*

*plotësuar (Shih, mutatis mutandis, ECHR, Azinass v. Cyprus, nr. 56679/00, Vendimi i datës 28 prill 2004)”.*

*Për sa i përket kësaj, Gjykata dëshiron të theksojë se parashtruesve të kërkesës ju kërkohet që të shterin vetëm mjetet juridike, të cilat janë efektive dhe në dispozicion. Mjetet diskrecionale ose te jashtëzakonshme nuk duhet të shteren, për shembull të kërkosh nga gjykata që të rishqyrtojë aktvendimin e saj (Shih, mutatis mutandis, ECHR, Cinar v. Turkey, nr. 28602/95, Vendimi i datës 13 nëntor 2003).*

*Kur parashtruesi i kërkesës ka provuar një prej mjeteve juridike, të cilin Gjykata e konsideron si të papërshtatshëm, kohëzgjatja e veprimit nuk e ndërpret rrjedhën e afatit kohor katërmujsh (neni 49, Afatet, i Ligjit), e cila mund të rezultojë në refuzimin e kërkesës si jashtë afatit (Shih, mutatis mutandis, ECHR, Prystavka, Rezgui v. France, nr. 49859/99, Vendimi i datës 7 nëntor 2000).*

35. Në këtë rast, parashtruesja konteston aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (*mjet juridik i jashtëzakonshëm*), me të cilin kjo e fundit aprovoi reviziononin e punëdhënësit të saj. Dhe, në mungesë të ndonjë mjeti tjetër të disponueshëm ligjor, në rrethanat e këtij rasti, Gjykata konkludon se parashtruesja e ka plotësuar kushtin e shterimit të mjeteve efektive juridike.
36. Gjithashtu, parashtruesja duhet të përmbushë kërkesat e nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36.1 (b) të Rregullores së punës, përkitazi me dorëzimin e kërkesës brenda afatit të paraparë me Ligj. Nga shkresat e lëndës vërehet qartë se vendimi i fundit për rastin e sajë është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 74/2011 i 12 marsit 2013. Kërkesën në Gjykatë, parashtruesja e dorëzoi më 19 qershor 2013, që nënkupton se kërkesa është parashtruar brenda afatit katër (4) mujor të paraparë me Ligj.
37. Gjykata vlerëson gjithashtu, nëse parashtruesja në kërkesën e saj ka saktësuar dhe qartësuar se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë shkelur, më cilin akt dhe nga cila gjykatë apo autoritet publik. Parashtruesja në kërkesën e saj ka përmendur saktësisht shkeljet e supozuara të të drejtave kushtetuese dhe gjithashtu ka dorëzuar dokumente të ndryshme në mbështetje të pretendimit të saj, përkitazi me faktin se Gjykata Supreme ia ka shkelur asaj të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
38. Pasi që kërkesa e parashtruesës përmbush kriteret e kërkuara procedurale për pranueshmëri, bazuar edhe në faktin që kërkesa është qartazi e bazuar, Gjykata Kushtetuese vendos se kërkesa e parashtrueses është e pranueshme për shqyrtim, andaj do të lëshohet më tutje në vlerësimin e meritave të kërkesës.

## Meritat e kërkesës

39. Parashtruesja pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 77/2011 i 12 marsit 2013, shkel të drejtat e saj themelore të garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, dhe posaçërisht, shkel nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 paragrafin 1 [E Drejta për Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.
40. Përkitazi me të drejtat e kërkuara nga parashtruesja, Gjykata rikujton se *“është autoriteti përfundimtar për karakterizimin që do të jepet në ligjin përkitazi me faktet e rastit dhe nuk është i lidhur me karakterizimin dhënë një parashtruesi ose një qeverie. Një ankesë është e karakterizuar nga faktet e pretenduara në të dhe jo thjesht nga bazat ligjore apo argumentet në të cilat mbështetet”*. (Shih, Aktgjykimi i GJEDNJ-së në Rastin *Ştefanica dhe të tjerët kundër Rumanisë*, i 2 nëntorit 2010, para. 23).
41. Prandaj, Gjykata do të analizojë ankesat e parashtrueses së kërkesës, bazuar në faktet e pretenduara dhe provat e bashkëngjitura në kërkesë, përkitazi me pretendimet e saja për shkeljen e të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ.
42. Parashtruesja e kërkesës, argumenton se Gjykata Supreme, vetëm tre muaj më vonë, në rrethana tërësisht të njëjta, me Aktgjykimin Rev. nr. 32/2013, aprovoi kërkesëpadinë dy të punësuarave tjera. Ndërsa në rastin e saj me të njëjtën bazë ligjore e njëjta gjykatë refuzoi kërkesëpadinë e saj. Ajo pretendon se ndërtimi i një praktike jokonsistente gjyqësore nga Gjykata Supreme, konfirmon mungesën e një gjykimi të drejtë dhe përveç që bie ndesh me praktikën e vetë gjykatës, shkel të drejtën e saj për një “gjykim të drejtë” sepse administrimi i drejtësisë në rastin e saj nuk garanton mbrojtje të barabartë të palëve në procedurë para asaj gjykate.
43. Sa i përket pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata i referohet dispozitave kushtetuese në vijim:
- Neni 31.1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës, parasheh se: *“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”*.
- Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] i Kushtetutës: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

Gjithashtu, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut parasheh: “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, ...nga një gjykatë... në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij...”.

### **Divergjencat e Gjykatës Supreme në rastin e parashtruese dhe të dy të punësuarave tjera**

44. Sipas parashtrueses, Gjykata Supreme, vetëm pak muaj pas rastit të saj, nxori Aktgjykimin Rev. nr. 32/2013, me të cilin është aprovuar, si e bazuar kërkesëpadia e dy të punësuarave tjera, në rrethana tërësisht të njëjta si të parashtrueses.
45. Gjykata Kushtetuese, pas gjetjeve nga shkresat e lëndës, vëren se aktgjykimi Rev. nr. 74/2011 (rasti i parashtrueses) dhe Rev. nr. 32/2013 (rasti i dy të punësuarave tjera) për nga baza ligjore e aplikuar, faktet dhe provat janë plotësisht të njëjta.
46. Sipas Aktgjykimit Rev. nr. 74/2011, rasti i parashtrueses: a) Palë e paditur para Gjykatës Supreme është Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (punëdhënësi); b) objekti i kontestit është shkelja e proceduarve të parapara me ligj dhe me aktin normativ të punëdhënësit; c) ndërprerja e kontratës së punës është bazuar në iniciimin e procedurës penale nga policia kufitare e Aeroportit; d) Baza ligjore për refuzimin e kërkesëpadiës është neni 11.3 pika d) e Rregullores 2001/27, për LTHPK “*sjellja e natyrës tepër të rëndë pas së cilës do të ishte e paarsyeshme që të pritet vazhdimi i marrëdhënies së punës edhe më te.*”
47. Sipas Aktgjykimit Rev. nr. 32/2013, rasti i dy punësuarave tjera: a) pale e paditur para Gjykatës Supreme, edhe në këtë rast, është Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (punëdhënësi); b) objekti i kontestit, edhe në këtë rast, është shkelja e proceduarve të parapara me ligj dhe me aktin normativ të punëdhënësit; c) ndërprerjen e kontratës së punës, edhe në këtë rast, është bazuar në iniciimin e procedurës penale nga policia kufitare e Aeroportit; d) baza ligjore për aprovimin kërkesëpadiës edhe në këtë rast, është neni 11.3 pika d) e Rregullores 2001/27 për LTHPK, “*sjellja e natyrës tepër të rëndë pas së cilës do të ishte e paarsyeshme që të pritet vazhdimi i marrëdhënies së punës edhe më te.*”
48. Është evidente se kërkesëpadia e parashtrues u refuzua, me të njëjtën bazë ligjore, më të cilën është aprovuar kërkesëpadia e dy të punësuarave tjera. Prandaj, meqë kemi të bëjmë me raste plotësisht të njëjta është e nevojshme që të kuptojmë se ku qëndrojnë këto dallime kundërthënëse në trajtimin e këtyre rasteve.
49. Në rastin e parashtrueses, Gjykata Supreme, kishte konstatuar se gjykatat e instancës me të ulët, në mënyre të plotë dhe të drejtë vërtetuan faktet dhe provat, por sipas saj, “*gabimisht aplikuan të drejtën material*” sepse në këtë

rast shkelja e detyrave të punës bazohet në piken d) të nenit 11.3 të Rregullores 2001/27, për LTHPK, qe përcakton, “*sjelljen e natyrës tepër të rëndë pas së cilës do të ishte e paarsyeshme që të pritej vazhdimi i marrëdhënies së punës*”.

50. Ndërkohë që në rastin e dy të punësuarave tjera, më të njëjtën bazë ligjore e njëjta gjykatë, i pranoi si të drejta konstatimet e gjykatave të instancës më të ulët, si në administrimin e provave po ashtu edhe në aplikimin e ligjit procedural dhe material, në vijim arsyetimi i gjykatës, për këtë rast: “*Është i drejtë konstatimi i gjykatave të instancës më të ulët se dispozita e nenit 11.3 (d) të Ligjit themelor të punës, si rast të rëndë të sjelljes së keqe, e cila është bazë për shkëputjen e kontratës së punës nga punëdhënësi, parasheh sjelljen e natyrës tepër të rëndë pas së cilës do të ishte e paarsyeshme që të pritet vazhdimi i marrëdhënies së punës edhe më tej. Mirëpo, për të shkëputur kontratën e punës për këtë bazë ligjore, i njëjti ligj në nenin 11.5. parasheh se në këtë rast punëdhënësi do të njoftojë punonjësën me shkrim për qëllimin e tij për të ndërprerë kontratën e punës, e ky njoftim përfshin edhe shkaqet për shkëputjen e kontratës së punës dhe se punëdhënësi do të mbajë një takim me punonjësën me ç’rast do t’ia shpjegojë me gojë shkaqet e shkëputjes së kontratës*”.
51. Çfarë parasheh Rregullorja 2001/27, për LTHPK, e cila është aplikuar në këto raste:

*Neni 11, Shkëputja e kontratës së punës:*

*11.1 Kontrata e punës shkëputet:*

*[...]*

*(c) në rastet e rënda të sjelljes së keqe nga punonjësi;*

*(ç) për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga ana e punonjësit;*

*[...]*

*11.2 Kontrata e punës shkëputet nga punëdhënësi në rastet e rënda të sjelljes së keqe ose të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga punonjësi.*

*11.3 Raste të rënda të sjelljes së keqe paraqesin:*

*(a) kundërshtimi i paarsyetuar për kryerjen e detyrave të përcaktuara në kontratën e punës;*

*(b) vjedhja, shkatërrimi, dëmtimi ose shfrytëzimi i paautorizuar i pasurisë së punëdhënësit;*

*(c) zbulimi i fshehtësive afariste;*

*(ç) përdorimi e drogave dhe i alkoolit në punë dhe*

*(d) sjellja e natyrës tepër të rëndë pas së cilës do të ishte e paarsyeshme që të pritet vazhdimi i marrëdhënies së punës edhe më tej.*

*11.5 Në rastet kur zbatohet neni 11.2: (a) punëdhënësi do ta njoftojë punonjësën me shkrim për qëllimin e tij për ta ndërprerë kontratën e punës. Ai njoftim përfshin edhe shkaqet për shkëputjen e kontratës së*

*punës dhe (b) punëdhënësi do ta mbajë një takim me punonjësin me ç'rast punëdhënësi ia shpjegon me gojë punonjësit shkaqet e shkëputjes së kontratës. Në rast se punonjësi është anëtar i ndonjë sindikate ka të drejtë që në atë takim të jetë i pranishëm edhe një përfaqësues i sindikatës.*

52. Dallimet në trajtimin e këtyre rasteve nga Gjykata Supreme, qëndrojnë në faktin se, në rastin e parashtrueses, ajo gjykatë në mënyrë selektive aplikoi normat ligjore, të cilat përmbushnin kërkesat vetëm të njërës palë, në rastin konkret vetëm të punëdhënësit, sepse Gjykata Supreme nuk mori parasysh të drejtat e parashtrueses që rrjedhin nga neni 11.5, siç i mori parasysh në rastin e dy të punësuarave tjera. Kjo norme ligjore ka paraparë ndjekjen e procedurave administrative, para se punëdhënësi të bie vendim për ndërprerjen e kontratës së punonjësit. Bazuar në ligjet e aplikueshme, janë nxjerrë edhe aktet normative që parashohin iniciimin e procedurës disiplinore.
53. Këtë qëndrim, Gjykata Supreme e ka mbajtur në të gjitha rastet tjera kur ka gjykuar me të njëjtën bazë ligjore, nga Rregullorja 2001/27, për LTHPK dhe nga Ligji nr. 12/1989 mbi marrëdhënien e punës në Kosovë. Kuptimi i këtyre normave ligjore shprehimisht përcakton se punëdhënësi duhet të zhvilloj procedurë administrative/disiplinore për t'i vlerësuar dhe kualifikuar shkeljet e detyrave të punës. Ngritja e komisioneve disiplinore është rregulluar me ligj dhe me akte normative juridike të secilit punëdhënës.
54. Parashtruesja, në kërkesë, ka përmendur disa raste në të cilat, Gjykata Supreme, kishte vendosur para dhe pas rastit të sajë, përkritazi me zhvillimin e procedurave që obligojnë punëdhënësin ndaj punonjësit, para se punonjësit t'i shkëputet kontrata e punës. Ato janë: Aktgjykimi, Rev. nr. 126/2007, i 17 janarit 2008; Aktgjykimi, Rev. nr. 177/2007, i 17 janarit 2008; dhe Aktgjykimi Rev. nr. 32/2013, i 30 korrikut 2013, në të cilin pikërisht thirret parashtruesja.
55. Gjykata Kushtetuese, vëren se, këtë qëndrim, sikurse në aktgjykimin Rev. nr. 32/2013 (rasti i dy të punësuarave tjera), Gjykata Supreme e ka mbajtur në të gjitha rastet tjera, që janë shtruar para saj, siç janë:

*Aktgjykimi, Rev. nr. 43/2006, i 21 shtatorit 2006, me të cilin është aprovuar revizioni i paditësit dhe janë prishur vendimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe çështja është kthyer në gjykatën e instancës së parë për rigjykim, pikërisht për shkak të shkeljes së procedurave dhe detyrimeve që dilnin nga neni 11.5 i Rregullores 2001/27, për LTHPK (Shih, Rastin KI103/13, të kësaj gjykate Mazllum Zena, nga paragrafi 18, i aktvendimit për papranueshmëri);*

Aktgjykimi, Rev. nr. 368/2011, i 2 majit 2013, me të cilin ishte aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe janë ndryshuar vendimet e instancave me të ulëta, për shkak të mos inicimit të procedurave disiplinore nga punëdhënësi, për t'i vlerësuar shkeljet e detyrave të punës. Në këtë rast Gjykata Supreme, ka theksuar se, për vlerësimin e shkeljeve nga marrëdhënia e punës, Ligji i aplikueshëm nr. 12/1998 për marrëdhënien e punës në Kosovë, parasheh inicimin e procedurave disiplinore dhe krijimi i komisioneve disiplinore për t'i kualifikuar shkeljet që burojnë nga marrëdhënia e punës (Shih, Aktvendimin për papranueshmëri, *Rasti KI 185/13, Korporata Energjetike e Kosovës, nga paragrafi 21*);

Aktgjykimi, Rev. nr. 151/2013, i 5 qershorit 2013, më të cilin po ashtu ishte aprovuar kërkesëpadia e paditësit me revizion dhe janë ndryshuar vendimet e instancave me të ulëta, për shkak të mos inicimit të procedurave disiplinore, për të vlerësuar shkeljet e detyrave të punës (Shih, *Aktvendimin për Papranueshmëri, Rasti, KI 186/13, Korporata Energjetike e Kosovës, paragrafi 20*).

56. Megjithatë, është evidente se, Gjykata Supreme vetëm në rastin e parashtrueses vendosi ndryshe nga rastet e përmendura më lartë. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme ka dështuar në trajtimin e barabartë të palëve në procedurë, për arsye se mori për bazë normën e cila kënaqtë vetëm kërkesat e njëres palë dhe nuk mori për bazë normën e cila ishte detyrim për punëdhënësin dhe e drejtë e parashtrueses. Në rastin konkret, nuk mund të thuhet që, Gjykata Supreme ka mbajtur të njëjtin qëndrim, për rastet analoge. (shih, *si është vepruar në rastin e të punësuarave tjera, aktgjykimi Rev. nr. 32/2013, i 30 korrikut 2013*).
57. Gjykata Supreme ka aplikuar Rregulloren 2001/27, për LTHPK, dhe në të gjitha rastet kur është aplikuar neni 11.1, 11.2 dhe 11.3 ka tërhequr vëmendjen tek gjykatat e instancës më të ulët, se për këto baza ligjore, ligjvënësi ka paraparë zbatimin e nenit 11.5 i cili obligon punëdhënësit që t'i zhvillojnë procedurat përkatëse. Por në rastin e parashtrueses nuk ka ndodhur kështu.
58. Edhe në rastet kur Gjykata Supreme ka aplikuar Ligjin mbi marrëdhënien e punës në Kosovë nr. 12/1989, baza kryesore e prishjes dhe e ndryshimit të vendimeve të gjykatave të instancës me të ulët, ishte pikërisht fakti se punëdhënësit arbitrarisht ua ndërpresin kontratat të punësuarve pa i zhvilluar procedurat përkatëse.
59. Ndërsa sa i përket testit, nëse kjo makineri është zbatuar, nga aktgjykimet e cituara të Gjykatës Supreme kuptojmë se në shumicën e rasteve është mbajtur qëndrim unik në aplikimin e atyre normave ligjore, përveç se në rastin e parashtrueses. Ndërtimi i një praktike tjetër gjyqësore, në rastin konkret, nuk mund thuhet se është bërë nga arsyeja e reformimit dhe e administrimit të qëndrueshëm të drejtësisë.



## **Sa i përket moskonsistencën së vendimeve për raste tërësisht të njëjta**

60. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së, respektivisht rastit Beian kundër Rumanisë, 30658/05, të 6 dhjetorit 2007, ku GJEDNJ-ja konstatoi që: “shkalla e lartë e pabarazisë së aktgjykimeve të Gjykatës së Kasacionit në Rumani për të njëjtat çështje ligjore vetvetiu është në kundërshtim me parimet e sigurisë juridike, që është implicite në të gjitha nenet e Konventës, dhe është njëri prej elementeve themelore të sundimit të ligjit.
61. Më tutje thuhet, se kjo pabarazi është bërë burim i pasigurisë juridike, duke dëmtuar besimin e publikut në gjyqësor. GJEDNJ-ja konstatoi se kjo pasiguri ka pasur efekt precedent të privimit të parashtruesit nga mundësia për t'i gëzuar të drejtat e parapara me ligj, përderisa individët tjerë në situata të njëjta i kanë gëzuar këto të drejta. Në vijim arsyetimi i vendimit në fjalë nga GJEDNJ-ja: *“Praktika e cila u zhvillua në kuadër të autoritetit më të lartë gjyqësor të vendit është në vetvete në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, parim i cili është i nënkuptuar në të gjitha nenet e Konventës dhe përbën një nga elementet themelore të sundimit të ligjit (shih, mutatis mutandis, Baranowski kundër Polonisë, nr. 28358/95, § 56, GJEDNJ 2000-III). Në vend se të përmbushë detyrën e saj të krijimit të interpretimit që duhet ndjekur, GJLKD-ja u bë vetë një burim i pasigurisë juridike, duke minuar besimin e publikut në sistemin gjyqësor (shih, mutatis mutandis, Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, § 97, GJEDNJ 2002-VII, dhe Padurarau, cituar më lart, § 98, shih gjithashtu, nga ana tjetër, Pérez Arias kundër Spanjës, nr. 32978/03, § 27, 28 qershor 2007). Prandaj, Gjykata konkludon se kjo mungesë e sigurisë në lidhje me praktikën gjyqësore kishte efektin e privimit të parashtruesit të kërkesës nga çdo mundësi e marrjes së përfitimeve të parashikuara me Ligjin nr. 309-2002, ndërsa personave të tjerë, në një situatë të ngjashme u janë dhënë këto përfitime. Rrjedhimisht, ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.”*
62. Në këtë rast, Gjykata Supreme, sipas detyrës zyrtare, do duhej kujdesur në zbatimin e praktikës së saj gjyqësore, duke evituar kështu shkeljet e të drejtave të palëve në procedurë para saj, dhe jo të bëhet vetë burim i pasigurisë juridike. Kjo mënyrë e administrimit të drejtësisë natyrisht që ndikon në uljen e besimit të qytetareve në sistemin gjyqësor.

## **Sa i përket dallimeve diskriminuese të trajtimit të rasteve tërësisht të njëjta**

63. Neni 24. paragrafi 1 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës, përcakton që: *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim”.*

64. Ky nen garanton para së gjithash barazinë e të gjithë qytetareve para ligjit dhe përcakton të drejtën e tyre për mbrojtje të barabartë gjyqësore, pa asnjë dallim mes tyre. Në fakt kuptimi i këtij neni është ndalimi kushtetues i diskriminimit, si parakusht themelor i sigurimit të respektimit të të gjitha të drejtave tjera të njeriut që i garanton Kushtetuta dhe realizimit të këtyre të drejtave në kushte të barabarta.
65. Lidhur me sigurimin e barazisë para ligjit, rrjedhimisht lidhur me ndalimin e diskriminimit mbi çfarëdo baze, duhet theksuar se ky nen përmban dispozita kushtetuese, qëllimi i të cilave është të eliminojë ose ndryshojë rrethanat që pengojnë arritjen e barazisë së personave ose grupeve të personave, të cilët faktikisht gjenden në pozitë të pabarabartë në raport me qytetaret tjerë.
66. Gjykata, sa i përket dallimeve diskriminuese, dhe trajtimit të barabartë të palëve para ligjit, tashme ka ndërtuar praktikën e sajë. Prandaj, në analogji me rrethanat e parashtrueses, Gjykata i referohet aktgjykimit të saj në rastin KIO4/12, të 11 korrikut 2012, publikuar më 20 korrik 2012, ku Gjykata përveç tjerash gjeti edhe shkelje të nenit 24 të Kushtetutës.
67. Përkitazi me këtë rast, Gjykata i është referuar praktikës së GJEDNJ-së, dhe citoi pjesë nga vendimet e saj: *“Në rastin Lithgov GJEDNJ theksoi se, neni 14 i KEDNJ-së i mbron personat [...] që janë vënë në situata të ngjashme nga dallimet diskriminuese në trajtim (Lithgov dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Baashkuar, Aktgjykimi i 8 korrikut 1986, Seria A, nr. 102; (1986) 8 EHRR 329). Përveç kësaj, në rastin Fredrin GJEDNJ theksoi se, në mënyrë që kërkesa e parashtruesit të jetë e suksesshme, duhet të konstatohet, ndër të tjera, që situata në të cilën gjendet viktimja e supozuar mund të konsiderohet e ngjashme me situatën e personave që kanë pasur trajtim më të mirë (shih Fredrin kundër Suedisë, Aktgjykimi i 18 shkurtit 1991, Seria A, nr. 192; (1991) 19 EHRR 784).*
68. Më tutje GJEDNJ theksoi se: *“Është obligim i gjykatave ose organeve lokale të tregojnë dhe dëshmojnë se trajtimi i një rasti ndryshe nga rastet e tjera me rrethana të ngjashme duhet të mbështetet me prova, të jetë bindës dhe i arsyetuar mirë. Në këtë drejtim, në rastin Lithgov GJEDNJ theksoi se: [...] për qëllime të nenit 14, dallimi diskriminues në trajtim është diskriminues nëse ky dallim nuk ka arsyetim objektiv ose të arsyeshëm, d.m.th. nëse nuk ndjek një synim legjitim.*
69. Në aktgjykimin e saj KIO4/12, Gjykata Kushtetuese konstatoj që *“Gjykata e Qarkut nuk i mori parasysh vendimet e veta të mëparshme për ta kualifikuar dhe gjykuar rastin e parashtruesit në përputhje me vendimet e veta duke u bazuar në parimin e të drejtës për trajtim të barabartë, siç kishte vendosur më parë në raste me rrethana plotësisht të ngjashme si të rastit të parashtruesit. Në këto rrethana, Gjykata, në pajtim me nenin 24 (Barazia para Ligjit) të Kushtetutës, konstatoj që ky dallim diskriminues*

*në trajtim përbënte shkelje të së drejtës për trajtim të barabartë para ligjit.”*

70. Prandaj, edhe në këtë drejtim, parashtruesja e kërkesës është venë në pozitë të pabarabartë me personat tjerë të cilët i fituan rastet e tyre, me të njëjtën bazë ligjore dhe në rrethanë plotësisht identike, sikurse të parashtrueses.

### **Mungesa e arsytimit të aktgjykimit në rastin e parashtrueses dhe zbatimi i parimeve të përgjithshme për këtë rast konkret**

71. Në mënyrë që Gjykata, të zbatojë testin nga GJEDNJ-së, në këtë rast, duhet që paraprakisht të analizojë nëse, në rastin e parashtrueses së kërkesës, Gjykata Supreme ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për refuzimin e argumenteve të saja, ose nëse aktgjykimi i saj tregon “arbitraritet të dukshëm”.
72. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet praktikës së vet gjyqësore, tashmë të vendosur përkritazi me detyrimet e gjykatave të rregullta për të ofruar arsye për aktgjykimet e tyre.
73. Për shembull në rastin e saj KEK, Aktgjykimi I-rë, më pas Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI72/12, Veton Berisha dhe Ifete Haziri, miratuar më 7 dhjetor 2012, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 1053/2008, të 31 majit 2012, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.
74. Në Aktgjykimin e vet të parë, rastet e KEK-ut, Gjykata kujton praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, si në vijim: *“Neni 6.1 i KEDNJ-së i obligon gjykatat të japin arsye për aktgjykimet e tyre. Megjithatë, kjo nuk nënkupton të kërkuarit e përgjigjes së detajuar në çdo argument apo pyetje. Masa, deri në të cilën aplikohet obligimi për të dhënë arsye, mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit. Për më tepër, është e nevojshme të merret parasysh, inter alia, shumëllojshmëria e parashtrësve që pala mund të sjellë para gjykatave dhe dallimet që ekzistojnë në Shtetet Kontraktuese në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, opinionin ligjor dhe prezantimin dhe hartimin e aktgjykimeve. Kështu, çështja nëse një gjykatë ka dështuar të përmbushë detyrimin të japë arsytet, që kërkohen nga neni 6 i Konventës, mund të përcaktohet vetëm në dritën e rrethanave të rastit (Shih, Ruiz Torija kundër Spanjës, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, Seria A, nr. 303-A, paragrafi 29).*
75. Dhe së fundmi, në rastin KI120/10’ Zyma Berisha, miratuar më 29 janar 2013, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 308/2007 të 10 qershorit 2011, Gjykata, gjeti shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 [E Drejta për Proces të Drejtë] të Konventës Evropiane

për të Drejtat e Njeriut, pikërisht, përkitazi me mosmarrjen parasysh të argumenteve të ngritura nga parashtruesja në kërkesëpadi.

76. Siç u vërejt më lartë, parashtruesja, përmes kërkesëpadisë së ushtruar, kërkoi anulimin e vendimit të punëdhënësit, si të kundërligjshëm, me theks të posaçme, për shkak se punëdhënësi i saj nuk përfilli asnjë procedure paraprake, për largimin e saj nga puna, siç parashihte ligji dhe akti normativ i punëdhënësit. I autorizuari i parashtrues, ka argumentuar se parashtrueses iu shkëput kontrata e punës në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm, sepse në bazë të ligjit dhe të aktit normativ, *“parashtruesja paraprakisht do duhej suspenduar gjer në përfundimin e procedurave, dhe assesi t’i ndërpritej kontrata e punës”*.
77. Në vend të kësaj, pikëpamja e Gjykatës Supreme, përkundër parashtrësave të parashtrueses, si objekt të çështjes, në rastin e saj, konsideroi natyrën e shkeljes së detyrave të punës nga neni 11.3 pika d), bazë ligjore të cilën e kanë aplikuar edhe gjykatat e instancës me të ulët, dhe nuk konsideroi pretendimet e parashtrueses, përkitazi me shkeljen e procedurave nga punëdhënësi i saj (neni, 11.5 ), qe ishte detyrim ligjor i punëdhënësit dhe e drejtë legjitime e parashtrueses. Ky fakt relevant, në rastin e parashtrueses, provon me së miri mungesën e vlerësimit objektiv dhe mungesën e arsytimit të aktgjykimit.
78. Për më tepër Gjykata vëren se, sipas të njëjtës bazë ligjore e njëjta gjykatë me Aktgjykimin Rev. nr. 32/2013, e kishte aprovuar kërkesëpadinë e dy të punësuarave tjera (kolegeve të saja) me të cilën janë konfirmuar vendimet e instancës më të ulët, të cilat urdhëruan punëdhënësin që ato t’i kthej në vendin e tyre të punës, në vijim konstatimi i Gjykatës Supreme, për këtë rast:

*“Është i drejtë konstatimi i gjykatave të instancës më të ulët se dispozita e nenit 11.3 (d) të Ligjit themelor të punës, si rast të rëndë të sjelljes së keqe, e cila është bazë për shkëputjen e kontratës së punës nga punëdhënësi, parasheh sjelljen e natyrës tepër të rëndë pas së cilës do të ishte e paarsyeshme që të pritet vazhdimi i marrëdhënies së punës edhe më tej.*

*Mirëpo, për të shkëputur kontratën e punës për këtë bazë ligjore, i njëjti ligj në nenin 11.5. parasheh se në këtë rast punëdhënësi do të njoftojë punonjësin me shkrim për qëllimin e tij për të ndërprerë kontratën e punës, e ky njoftim përfshin edhe shkaqet për shkëputjen e kontratës së punës dhe se punëdhënësi do të mbajë një takim me punonjësin me ç’rast do t’ia shpjegojë me gojë shkaqet e shkëputjes së kontratës.”*

79. Megjithatë në rastin e parashtruese, Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar përse nuk ka qenë e nevojshme zhvillimi i procedurave të parapara me ligjin e aplikueshëm(neni 11.5), përderisa në rastet tjera tërësisht të ngjashme,

para dhe pas rastit të saj gjykoj si të domosdoshëm zhvillimin e procedurave administrative para ndërprerjes së kontratës së punës.

80. Në këto rrethana, Gjykata Supreme, në rastin e parashtrueses, nuk i plotësoi detyrimet e saj sipas nenit 6.1 të KEDNJ-së, për të dhenë mjaftueshëm arsyet e duhura për refuzimin e kërkesëpadisë së parashtrueses me revizion. Në bazë të fakteve dhe rrethanave tërësisht të ngjashme me ato të rastit të saj, parashtruesja e kërkesës në mënyrë legjitime mund të priste refuzimin e revizionit të ushtruar nga punëdhënësi i saj.
81. Trajtimi i parashtrësave në mënyrë të duhur, nga ana e gjykatës, gjatë procedurës civile, është thelbësor për korrektësinë e procedurës civile kontestimore. Gjatë shqyrtimit të një lënde, gjykata ka për detyrë t'i shqyrtojë në mënyrë efikase bazat, argumentet dhe provat e paraqitura nga palët. Dështimi i gjykatës për t'i shqyrtuar në mënyrë të duhur argumentet specifike, përkatëse dhe të rëndësishme të palës, nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në vazhdimësi është konsideruar si shkelje e nenit 6 të KEDNJ-së.
82. Arsyetimi i aktgjykimit është një përbërës kyç i gjykimit të drejtë dhe është esencial për ndarjen e drejtësisë dhe është treguesi më i mirë që dëshmon se gjykatat i kanë të bazuara thëniet në vendimet e tyre. Funkcion i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar. Nga ana tjetër, vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të realizohet një kontroll publik i administrimit të drejtësisë (shih, *Tatishvili kundër Rusisë, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 9 korrikut 2007, paragrafi 58. Dhe rastin Hirvisaari kundër Finlandës, me ndryshimet përkatëse, paragrafi 30, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 27 shtatorit 2001*).
83. Parimi i shtetit të së drejtës, ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Siguria juridike, si koncept kushtetues, përfshin qartësinë, kuptueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit normativ.
84. Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese, duke i marr parasysh të gjitha parimet e shtjelluara më lartë përfundon se: vendimi i kontestuar shkel të drejtat e parashtruese për gjykim të drejtë; shkel të drejtën e parashtrueses për trajtim të barabartë para ligjit; është në kundërshtim me praktiken gjyqësore të vetë asaj gjykate dhe me parimin e sundimit të ligjit dhe të sigurisë juridike.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në seancën e saj të mbajtur më 12 mars 2014, me shumicë votash:

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJ kërkesën të pranueshme;
- II. KONSTATON se ka pasur shkelje të nenit 24 [Barazia para ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, nenit 6.1 [E Drejta për Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. SHPALL të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 74/2011, të 12 marsit 2013;
- IV. KTHEN Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për rivendosje, në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese;
- V. MBETET e përkushtuar ndaj çështjes, në pritje të respektimit të këtij urdhri;
- VI. URDHËRON që ky aktgjykim t'u komunikohet palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;
- VII. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Prof. dr. Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani